Kronikë

Qëllohet me armë makina e nipit të Kastriot Reçit në Rrëshen, ngjarja pas një sherri më një bashkëmoshatar! Pasi u qëllua bëri aksident me makinë! Në kërkim babë e bir

Një konflikt mes disa personave në Mirditë është shoqëruar të shtëna me arme zjarri, por fatmirësisht nuk ka persona të lënduar. Ngjarja ka ndodhur ne qytetin e Rrëshenit pak minuta më parë

Kastriot Reçi

Redaksia
26 Mars, 20:13 | **Përditesimi: 26 Mars, 21:01**

RRËSHEN- Një konflikt mes disa personave në Mirditë është shoqëruar të shtëna me arme zjarri, por fatmirësisht nuk ka persona të lënduar. Ngjarja ka ndodhur ne qytetin e Rrëshenit pak minuta më parë.

Fillimisht janë përplasur fizikisht dy të rinj me njëri-tjetrin, e më pas babë e bir kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të makinës së Saimir Reçit, nipin e ***Kastriot Reçit*** të ekzekutuar në 2020. Gjatë largimit të këtij të fundit nga vendi i ngjarjes, për shkak të të shtënave me armë, ai ka humbur kontrollin e mjetit dhe është përplasur me bordurën rrugës.

LEXO EDHE:
Del FOTO nga aksidenti në Kurbin, makina e kthyer përmbys ka përfunduar në arë, humb jetën shoferi

Policia sqaron se dy të rinjtë u përplasen fizikisht me njëri-tjetrin dhe më pas, i riu Enrik Bardhi ka shkuar në banesë ka marrë armën dhe bashkë me të atin Martin Bardhi kanë qëlluar në drejtim të mjetit. Nga të shtënat fatmirësisht nuk ka persona të lënduar. Janë ngritur pika kontrolli, si dhe vijon kontrolli i zonës, për të kapur dy autorët.

Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon veprimet hetimore në vendin e ngjarjes, me qëllim zbardhjen e plotë dhe dokumentimin ligjor të ngjarjes.

Lajmi do të përditësohet...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 20:55

Të shtënat me armë pas një sherri në Rrëshen, objektivi nipi i Kastrot Reçit! I ekzekutuar në 2020-n

Saimir Reçi, objektivi i sotshëm pas një sherri me Enrik Bardhin është nipi i Kastriot Reçit, i ekzekutuar në vitin 7 janar 2020. Saimir Reçi është përplasur fillimisht fizikisht me Enrik Bardhin i cili më pas ka shkuar në banesë të marrë armën dhe së bashku me të atin e tij kanë qëlluar me armë zjarri drejt makinës së Saimir Reçit, i cili më pas është aksidentuar pasi ka humbur kontrollin e mjetit.

G.MO/LR/Shqiptarja.com

TAG: Lezhe mirdite freshen sherr te shtena me arme Martin Bardhi enrik bardhi saimir reci

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Lista e PS për 14 Majin me 44 rikandidime e 17 emra të rinj, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

TIRANË/ Të shtëna me armë zjarri në Lundër! Qëllohet drejt banesës së zyrtarit të OSHEE! Shkak konflikti për pronat, s'ka të lënduar
26 Mars, 09:52

Aksident me vdekje në aksin Laç-Mamurras, mjeti del nga rruga, ndërron jetë shoferi! Një i plagosur
26 Mars, 08:34

Qëlluan me armë zjarri para banesës së një personi vetëm se u kërkoi të mos xhironin gomat e makinës, shpallen në kërkim dy adoleshentët në Lezhë (EMRAT)
25 Mars, 19:58

Berisha thirrje simpatizantëve demokratë në Kurbin: Mos bëni gabim të shkoni pas Alibeajt! Nuk përkulemi para pengjeve të Ramës
25 Mars, 19:13

Jetojnë në mes të ujërave të zeza, banorët e pallatit nr.10 në Lezhë ngrihen në protestë: Shkarkohen nga banesat private, bashkia të gjejë zgjidhje
Elvis Hila
25 Mars, 12:59

VIDEO/ Digjen mbetje poshtë urës në lumin e Drojës, shtëllungat e tymit mbulojnë autostradën dhe zonën në Fushë-Mamurras
25 Mars, 11:14

Aksident rrugor në aksin Tiranë-Lezhë, përplasen dy mjete, shoqërohen drejtuesit
24 Mars, 20:53

Sherr për ujin e pijshëm në Librazhd, 3 persona dhunojnë një të moshuar me lopatë
24 Mars, 14:36

Punonjësit e portit te Shëngjinit sërish në protestë! Nuk janë paguar prej 3 muajsh, kërkojnë zgjidhje të problematikës
Elvis Hila
24 Mars, 11:02

Harrohet kriza energjetike, ndriçuesit e rrugës në Milot ndezur edhe ditën (VIDEO)
Elvis Hila
23 Mars, 12:39

Shëngjini turistik i lënë pas dore, s'ka investime në rrugë e kanalizime! Banorët: Problem prej 40 vitesh
Elvis Hila
22 Mars, 17:34

Ndryshime në Policinë e Shtetit, lëvizin shefat e komisariateve në Lezhë, Laç, Mirditë, Kukës e Kavajë
Sokol Dema
21 Mars, 10:52

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje